



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"
SENATI

Nr. 2481 prot.

Shkodër, më 08.08.2024

V E N D I M

Nr. 173, datë 08.08.2024

“Për miratimin e disa planeve mësimore të programeve të studimit të ciklit të parë dhe ciklit të dytë në USH”

Në mbështetje të Ligjit nr. 80/2015, dt 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Neni 38 pika 1, germa dh, Nenet 73 dhe 75 ; Statutit të USH-së, Neni 17, pika 6, germa f, Nenet 51-53; VKM-së nr.41, datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL-të”, i ndryshuar me VKM-në nr.879, datë 18.12.2019; Senati Akademik, pasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë, në mbledhjen e tij të datës 08.08.2024

Vendosi:

1. Miratimin e disa planeve mësimore në programet e studimit të ciklit të parë dhe ciklit të dytë, sistemi me kohë të plotë, vitet akademike 2024-2027, 2024-2025, 2024-2026, të Fakultetit të Shkencave të Edukimit, sipas materialit bashkëlidhur këtij vendimi, si vijon:
 - **Cikli i parë i studimeve, Bachelor 2024-2027**
Bachelor në “Psikologji”
Bachelor në “Punë Sociale”
 - **Cikli i dytë i studimeve, 60/120 ECTS**
Master Profesional “Shërbimet Sociale”
Master i Shkencave në “Psikologji Klinike”
Master i Shkencave në “Psikologji Organizative”
2. Ngarkohen Njësitë kryesore dhe Drejtoria e Kurrikulave, kërkimit shkencor dhe standardeve për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE

Prof. Dr. **Rajmonda KECIRA**

